



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

Date 07.10.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Makineri, Pajisje Për Autoritetin Rrugor Shqiptar Dhe drejtoritë rajonale.

VLERA E FONDIT LIMIT:

82,112,790 (tetëdhjetë e dy milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH ose 830,933 (tetëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) Euro pa TVSH.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 07.10.2024 është 98.82 lekë.

Duke ju referuar kërkesës së Autoritetit Rrugor Shqiptar ku nevoja për këto mjete/materiale është sipas fushës së veprimtarisë së tij, menaxhimi i rrjetit rrugor shtetëror, në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor dhe të këtij ligji Nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, parashikohet se:

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo procedurë është e pamundur teknikisht të ndahet në kontrata të ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit kemi të bëjmë me mjete të së njëjtës natyre që kryejnë funksionin e menaxhimit të rrjetit rrugor shtetëror dhe përdoren të gjitha për të njëjtin qëllim, sipas fushës së veprimtarisë së institucionit.

AK gjykon se ndarja në lote e kontratës së mësipërme nuk është praktike, pasi malli i kërkuar nuk mund të copëzohet dhe duhet të jetë i gjithi për kryerjen e shërbimit në të gjithë territorin.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar neni 2 prashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar neni 14, Operatorët ekonomikë, parashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik. Në vendimin Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme,

në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njih gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetem paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme.

Mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon tregun, pasi kriteret e hartuara në DST janë gjithëpërfshirëse, që u jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.

NJËSIA E PROKURIMIT